



Buletini nr. 163- Qershor- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Buletini nr. 163- Qershor - 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Shënimi i Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës



Permbajtja:

Shënohet 1 Qershori-Dita e Fëmijëve.....	3
Në përvjetorin e rënies, shënohet dita e shkollës që mban emrin e dëshmorit Ibrahim Mazreku	4
U promovua libri “Arsimi në Komunën e Malishevës”	4
14 shkolla, furnizohen me pajisje teknologjike	5
Mërgimtarët ndihmojnë një familje në meremetimin e shtëpisë.....	5
SHFMU “Visar Krasniqi” shënoi ditën e shkollës	6
Kryetari Begaj, inspektoi punimet e rrugës në Drenoc.....	7
Ndriçimi i qytetit të Malishevës, drejt përfundimit	8
Filloi asfaltimi i transitit të vogël në Malishevë	8
Shkolla në Berishë, do të jetë e gatshme për shtator	9
KK i Malishevës, vendosi për çmimet tradicionale të 16 Qershorit.....	10
Gjashtëqindpesëdhjetetë nxënës i nënshtrohen „Testit të Maturës Shtetërore”	11
Kryetari Begaj, priti kampionët e Kosovës të volejbollit shkollor.....	11



Filloi ndërtimi i aneksit të gjimnazit në Malishevë	12
U përkujtua dëshmori i parë i Malishevës, Imer Krasniqi.....	13
Shkolla e Dragobilit, bëhet me bibliotekë.....	13
U mbajtën shumë aktivitete kulturore në vigjilje të shënimit të 16 Qershorit	14
Malisheva po shënon 16 Qershorin, Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve.....	15
Këshilli i Drejtorëve diskutoi për Kornizën Afatmesme Buxhetore	17
Filloi asfaltimi i 700 metrave rrugë në lagjet e Gurbardhit	17
Viti shkollor afër përfundimit.....	18
Begaj: Me hapjen e bizneseve të reja, po krijohen vende pune	19
Ushtrimi fushor “Mirusha 2017”, në fazën finale të përgatitjeve	20
Filloi hapja e dy rrugëve në Balincë	20
Edhe në Mleqan rregullohen rrugët brenda fshatit	21
KKSB: Malisheva komunë e qetë	22
KK i Malishevës, miratoi KAB-in dhe emërtoi stadiumin e qytetit	23

Shënohet 1 Qershori-Dita e Fëmijëve

Malishevë, 1 qershor



Përmes aktiviteteve të ndryshme, në Komunën e Malishevës, po shënohet Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Krahas këtyre aktiviteteve, edhe Drejtoria për Arsimit dhe Edukim, në bashkëpunim me institucionet shkollore, ka organizuar një program për fëmijë, në parkun e qytetit në Malishevë, ku fëmijët po i shfaqin talentet e tyre, përmes paraqitjeve të ndryshme, e që lidhen me 1 Qershorin-Ditën e Fëmijëve.

Në hapje të këtij programi, drejtori komunal për arsim, Avdi Morina, i ka përshëndetur të gjithë fëmijët e Komunës së Malishevës dhe i ka uruar me rastin e 1 Qershorit. “Jo vetëm që e kemi



obligim, por do të bëjmë të pamundurën, që të investojmë në ardhmërinë e fëmijëve, për krijimit të kushteve sa më të mira në arsim, në edukim dhe për zhvillimin e aktiviteteve të lira”, tha mes tjerash drejtori i arsimit Avdi Morina.

Më pas, fëmijët nga shkollat apo institucionet e ndryshme edukative dhe arsimore, kanë dhënë një shfaqje, me recitime, këngë, vallëzime dhe shfaqje të talentit, si gjimnastikë, akrobaci dhe të ngjashme.

Në përvjetorin e rënies, shënohet dita e shkollës që mban emrin e dëshmorit Ibrahim Mazreku

Malishevë, 2 qershor

Sot, SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, shënoi ditën e shkollës e cila mban emrin e dëshmorit të kombit Ibrahim Mazreku, i rënë më 2 qershor të vitit 1999. Në këtë shënim morën pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i arsimit, Avdi Morina, përfaqësues të shkollës “Tahir Sinani” nga Paskuqani i Tiranës (shkollë e binjakëzuar me shkollën në Malishevë), përfaqësues të shoqatave të dala lufta dhe qytetarë të shumtë.




Në fjalimin e rastit, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, tha se “emri, jeta dhe vepra e Ibrahim Mazrekut, do të jetojnë aq sa do të jetoj kombi shqiptar dhe njerëzimi në përgjithësi”. Begaj, i uroi nxënësit dhe mësimdhënësit, me rastin e shënimit të ditës së shkollës.

Më pas, nxënësit e SHFMU “Ibrahim Mazreku”, kanë dhënë një program kulturor dhe artistik.

U promovua libri “Arsimi në Komunën e Malishevës”

Malishevë, 2 qershor



Sot, në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, është promovuar libri “Arsimi në Komunën e Malishevës” (pas luftës së dytë botërore-historik i shkurtër), me autor Fatmir Fejzë Krasniqi. Përmes këtij libri, autori është munduar të sjellë të dhëna nga



fillimet e para të hapjes së shkollave shqipe, në territorin e Komunës së Malishevës, e deri më sot.

Redaktor i librit është Habib Zogaj, ndërsa recensent Gani Zogaj, të cilat edhe kanë folur rreth librit, rëndësisë dhe mënyrës se si është shkruar libri, faktet e mbledhura dhe të dokumentuara.

Edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka folur në këtë promovim, i cili tha se “ndonëse nuk është kritik letrar, por e vlerëson çdo përpjekje për të shkruar vepra, të cilat kanë rëndësi. Çdo shkronjë që shkruhet për arsimin është shkronjë e artë”, tha Begaj.

14 shkolla, furnizohen me pajisje teknologjike

Malishevë, 6 qershor

Në kuadër të investimeve në shkollat e Komunës së Malishevës, me qëllim të efikasitetit në punë dhe me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për mësimdhënësit dhe menaxhmentin e shkollave, Drejtoria për Arsimit dhe Edukimin, sot ka pajisur edhe katërmëdhjetë shkolla, me pajisje teknologjike.



Me këtë rast, drejtori Drejtorisë për Arsimit dhe Edukimin, Avdi Morina, tha se drejtoria që drejton, është e përkushtuar në krijimin e kushteve sa më të mira në shkollat e Komunës së Malishevës, në rastin konkret, janë pajisur katërmëdhjetë shkolla me aparate për printim, skanim dhe fotokopje, me qëllim të kryerjes së punëve të përditshme në shkolla, nga ana e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave”.

Përndryshe, të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës, janë të pajisura me shërbim të internetit dhe pajisje tjera të teknologjisë, ndërsa furnizimi me pajisje të printimit, skanimit dhe kopjimit, bëhet në vazhdimësi, varësisht nga qëndrueshmëria e pajisjeve.

Mërgimtarët ndihmojnë një familje në meremetimin e shtëpisë

Malishevë, 7 qershor



Me iniciativë të mërgimtarëve tanë, në Gjermani, janë siguruar mjetet për meremetimin e shtëpisë për familjen e Elmi Begajt nga Banja. Për këtë qëllim sot, në zyrën e Kryetarit të Komunës ka qëndruar mërgimtari dhe humanisti Besir Bytyçi nga Shkoza, i cili edhe e ka njoftuar kryetarin e komunës, për këtë donacion. Këtij donacioni i shtohen edhe një pjesë tjetër e mjeteve të siguruara nga Komuna e Malishevës dhe shumë shpejt

pritet që kjo familje të ketë të zgjidhur problemin e banimit.

Besir Bytyçi, ka njoftuar se “shumë mërgimtarë i janë përgjigjur kësaj initiative dhe janë grumbulluar një sasi e mjeteve prej gjashtë mijë euro, për meremetimin e brendshëm të shtëpisë së Elmi Begajt.” Bytyçi, ka falënderuar edhe Komunën për bashkëpunimin e mirë, në këtë iniciativë.

Nga ana tjetër, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka falënderua humanistin Bytyçi dhe të gjithë mërgimtarët, të cilët kanë kontribuar në grumbullimin e mjeteve, për meremetimin e kësaj shtëpie. “Ne si komunë, kemi ndërtuar pesë shtëpi këtë vit, dhe përsëri do ti ndihmojmë familjet në nevojë, ndërsa në rastin konkret edhe ne si komunë, kemi ndarë një shumë të caktuar, por çdo ndihmë që vjen nga mërgimtarët tanë, ka rëndësi të madhe, jo vetëm për familjen në fjalë, por për të gjithë ne, prandaj, i falënderoi të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre për këtë familje dhe në të gjitha rastet tjera”, tha Begaj, duke shprehur falënderimin e tij për të gjithë mërgimtarët.

Besir Bytyçi, ka bërë të ditur se kjo iniciativë ka fillua kohë më parë, ndërsa mërgimtarët të cilët kanë kontribuar me mjete janë: Bekim Bytyçi, Muhamet Bytyçi, Bahri Tahiri, Ramadan dhe Behar Kovaçi, Rifat dhe Haki Qamili, Gani Nuha, Haxhi Hoxha, Bajam Behrami, Ismet Jusufi, Agron Begaj, Imer Brahimi dhe Sajmir Ukaj.

SHFMU “Visar Krasniqi” shënoi ditën e shkollës

Malishevë, 7 qershor



Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Visar Krasniqi” në Drenoc, sot ka shënuar ditën e shkollës, ku krahas punës në shkollë, u përkujtua edhe dëshmori i kombit, Visar Krasniqi, emrin e të



cilit e mbanë kjo shkollë. “Falë gjakut të Visarit dhe dëshmorëve të tjerë, ne sot festojmë të lirë”, u tha në këtë shënim.

“Të jeni krenar me emrin që mban shkolla juaj, pasi falë gjakut të dëshmorëve të kombit, ne sot i gëzojmë dhe i shënojmë këto ditë të shkollave dhe datat tjera me rëndësi”, tha kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në fjalën e rastit. Kryetari Begaj, gjithashtu kërkoi nga mësimitdhënësit që të jenë të përkushtuar në rritjen e cilësisë në mësimitdhënie.

Sh.F.M.U. “Visar Krasniqi”, është njëra prej shkollave më të reja në Komunën e Malishevës, ndërsa ndërtimi i saj, ishte domosdoshmëri, për shkak të largësisë që kishte shkolla në qendër të fshatit, me lagjet, sepse Drenoci, është një prej vendbanimeve më të mëdha në Komunën e Malishevës dhe lagjet janë shumë të shpërndara.

Kryetari Begaj, inspektoi punimet e rrugës në Drenoc

Malishevë, 7 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në kuadër të kryerjes së punëve të përditshme, sot ka inspektuar realizimin e projektit të rregullimit të rrugës, që lidhë lagjet Lacaj dhe Latifaj në Drenoc. Kryetari Begaj, është ndarë i kënaqur me ecurinë e punimeve në këtë rrugë me rëndësi për banorët e Drenocit, pasi përmes kësaj rruge, lidhen edhe lagjet tjera të fshatit.

“Hapja e kësaj rruge ka rëndësi të madhe, andaj kërkoj që punimet të vazhdojnë ashtu siç janë nisur, mirë dhe mbarë. Deri më tani është bërë hapja e rrugës, kurse në ditët në vijim do bëhet baza dhe përgatitja për asfaltim”, tha Begaj.

Banorët e Drenocit, e kanë vlerësuar si një prej investimeve më me rëndësi, jo vetëm për banorët e dy lagjeve, por për tërë fshatin, pasi lagjet tjera i kanë rrugët e rregulluara dhe tani edhe me




këtë rrugë, mundësohet lëvizja e lehtë dhe e shpejtë mes të gjitha lagjeve dhe nuk kanë nevojë të bëjnë kilometra të tëra, për të shkuar në këto lagje.

Ndriçimi i qytetit të Malishevës, drejt përfundimit

Malishevë, 9 qershor

Ndriçimi në qytetin e Malishevës, është futur në fazën përfundimtare, ku brenda dy ditëve pritet të përfundoj në tërësi rregullimi i ndriçimit aktual dhe vendosja e ndriçimit në dy rrugë të reja, përkatësisht në lagjet Hoti dhe Veselaj. Kështu ka deklaruar sot, drejtori i urbanizimit Ahmet Morina, sipas të cilit, ndriçimi është rregulluar në pjesën më të madhe të qytetit, përfshi edhe parkun e qytetit.



“Jemi në fazën finale të rregullimit të ndriçimit në tërë qytetin e Malishevës, dhe brenda dy ditëve besojmë se do të përfundoj edhe ky projekt me rëndësi për banorët e Malishevës. Në kuadër të rregullimit të ndriçimit, është bërë eliminimi i defekteve dhe zëvendësimi i poqeve ekzistuese me poqë ekonomike, duke e ruajtur cilësinë e ndriçimit”, tha Morina.

Përveç eliminimit të defekteve, ndriçimi është rregulluar në tërësi në të gjitha rrugët, si dhe janë ndriçuar edhe dy rrugë të reja,, njëra në lagjen e Hotëve dhe tjetra në lagjen Veselaj. Gjithashtu është rregulluar ndriçimi edhe në parkun e qytetit, si vendin më i frekuentuar nga qytetarët”, ka deklaruar Morina.

Në dy vitet e fundit, Komuna e Malishevës, ka investua në rregullimin e ndriçimit, në qytetin e Malishevës dhe në disa vendbanime tjera. Krahas ndriçimit në rrugët kryesore në qytet, janë ndriçuar edhe katër rrugë, apo katër lagje të reja, si dhe është rregulluar ndriçimi edhe në Kijevë dhe Bellanicë.

Filloi asfaltimi i transitit të vogël në Malishevë

Malishevë, 9 qershor



Sot në qytetin e Malishevës, ka filluar asfaltimi i rrugës që lidhë tri lagje dhe e cila do të shërbejë si rrugë transite për ngasësit e veturave. Ndërtimi dhe asfaltimi i kësaj rruge, është njëri prej projekteve më me rëndësi për qytetin e Malishevës, sa i përket infrastrukturës rrugore, pasi krahas lidhjes së lagjeve, do të mundësoj edhe shkarkimin e qytetit nga numri i madh i veturave, sidomos gjatë stinës së verës.



Në fillimin e asfaltimit të kësaj rruge, ishin prezent edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, të cilët u ndanë të kënaqur me ecurinë e deritanishme të punimeve në rregullimin e kësaj rruge, e cila shumë shpejt do të jetë e gatshme për qarkullim.

“Derisa të ndërtohet rruga transite, kjo rrugë do të luaj këtë funksion për të gjithë ngasësit e veturave, të cilët mund ti ikin tollovisë në qytet, sidomos në sezonin e verës, ku numri i veturave është shumë i madh. Qëllim i yni është sigurimi më i lehtë i lëvizjes për të gjithë qytetarët apo ngasësit e veturave dhe nga tani, kjo rrugë do të krijojë lehtësi për ngasësit, pasi mund ta shfrytëzojnë këtë rrugë, si një alternativë për ti ikur tollovisë brenda qytetit”, tha kryetari Begaj.

“Me asfaltimin e kësaj rruge, e cila është ndërtuar me qëllim të lidhjes së lagjeve Hoti me lagjen Mirëdita dhe lagjen e Gurit, në të njëjtën kohë, do të shërbej edhe si rrugë transite e cila fillon në hyrje të qytetit në veri dhe përfundon në jug të qytetit në lagjen e Gurit”, tha drejtori i urbanizimit, Morina.

Shkolla në Berishë, do të jetë e gatshme për shtator



Malishevë, 9 qershor

Fshati Berishë, deri më 1 shtator të këtij vitit, do të ketë të gatshëm objektin e ri të shkollës, për fillimin e vitit të ri shkollor, pasi punimet



në ndërtimin e shkollës, janë në përfundim e sipër. Punimet në këtë shkollë, sot i ka parë nga afër edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, bashkë me drejtorin e urbanizmit, Ahmet Morina.

“Punimet kanë ecur mirë dhe ky objekt do ti plotësoj në tërësi nevojat e nxënësve të fshatit Berishë dhe Fshatit të Ri. Deri në këtë vit, në objektin aktual, nxënësit nuk kanë pasur kushte për mësimnxënie, por as arsimtarët për mësimdhënie, pasi objekti nuk i ka plotësuar as kushtet minimale për zhvillim të procesit mësimor”, tha kryetari Begaj. “Ne jemi të përkushtuar në krijimin e kushteve sa më të mira në shkollat tona dhe rritjen e cilësisë në mësim, dhe ndërtimi i objekteve shkollore sipas standardeve është hapi i parë për arritjen e këtij objekti”, tha Begaj, i cili shprehi edhe kënaqësinë e tij për ecurinë e punimeve dhe arritjes së këtij qëllimi.

Në anën tjetër, drejtori i urbanizmit Ahmet Morina, si përgjegjës për realizimin e projekteve infrastrukturore, tha se “punimet deri më tani kanë shkuar sipas ecurisë së planifikuar dhe deri më 1 shtator, kjo shkollë do të jetë e gatshme për pranimin e nxënësve brenda dhe zhvillimin e procesit mësimor”.

KK i Malishevës, vendosi për çmimet tradicionale të 16 Qershorit

Malishevë, 14 qershor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e pestë të radhës për këtë vit dhe ka marrë dy vendime me rëndësi. Vendimi i parë ka të bëjë me çmimet tradicionale që ndahen me rastin e shënimit të 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës dhe vendimi i dytë ka të bëjë me dhënie në shfrytëzim të pishinave në Banjë.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, me shumicë të votave, ka miratuar propozimet e Këshillit Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, për ndarjen e çmimeve, si vijon: çmimi “Imer Krasniqi” për trimëri dhe heroizëm, ju ndahet veteranës së luftës së UÇK-së Bukurie Zogajt dhe veteranit tjetër të UÇK-së, Nuhi Krasniqi, çmimi “Hamdi Berisha” për kontribut në shkollën shqipe, ju nda veteranëve të arsimit Ahmet Hoxha dhe Ahmet Krasniqi, ndërsa çmimi “Shpëtim Robaj” për kontribut në fushën e mjekësisë, ju nda mjekëve Ali Krasniqi dhe Besim Zogaj.

Vendimi i dytë me rëndësi, ishte edhe miratimi i raportit përfundimtar të Komisionit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, përkatësisht pishinave në Banjë, sipas



konkursit, përkatësisht ankandit publik të shpallur më datë 5 maj 2017. Bazuar në raport, pishinat i ka marrë në shfrytëzim operatori ekonomik, me çmimin më të lartë, prej 22 117 euro.

Gjashtëqindpesëdhjetetë nxënës i nënshtrohen „Testit të Maturës Shtetërore”

Malishevë, 14 qershor

Si në tërë vendin, edhe në Malishevë, sot është mbajtur “Testi i Maturës Shtetërore”, ku gjashtëqindpesëdhjetetë maturantë nga Komuna e Malishevës, i janë nënshtuar këtij testi. Ecurinë dhe mbarëvajtjen e mbajtjes së testit të maturë, e ka parë nga afër edhe drejtori komunal i arsimit Avdi Morina, i cili e vlerësoi organizimin e mirë të këtij testi, ku ishin siguruar të gjitha kushtet e nevojshme për mbajtjen e testit.

Sipas drejtorit të arsimit në Malishevë, këtij testi i janë nënshtuar gjashtëqindpesëdhjetetë maturant. Në gjimnazin “Hamdi Berisha”, testit i janë nënshtuar katërqindpesëmbëdhjetë maturant, në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” njëqindpesëdhjetetë maturant dhe në Shkollën e Mesme Profesionale Ekonomiko-Juridike “Lasgush Poradeci”, tetëdhjetepesë maturant.

Me këtë rast, gjatë vizitës së tij në shkollat ku mbahej testi i maturës, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, i ka uruar të gjithë nxënësit, përkatësisht maturantët të cilët i janë nënshtuar këtij testi dhe ju ka dëshiruar sukses në test.

Kryetari Begaj, priti kampionët e Kosovës të volejbollit shkollor

Malishevë, 15 qershor



Në kuadër të aktiviteteve të shumta me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Malishevës, dhe Ditës së Dëshmorëve, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, sot ka pritur ekipin e volejbollit të SHFMU “Ismail Qemajli” nga Bellanica, të cilat janë shpallur kampion në nivel



republike, në kuadër të garave të sportit shkollor.

“Unë ju uroj për këtë sukses dhe juve ju dëshiroj që të keni shëndet në rend të parë dhe uroj që sukseset e juaja të mos ndalen. Ne po mundohemi të krijojmë kushte të mira në shkollat tona, përmes investimeve në infrastrukturën shkollore dhe ju me këto suksese, më së miri i tregoni këto investime në infrastrukturën shkollore”, tha kryetari Begaj.

Ekipi i volejbollit të kësaj shkolle, për herë të dytë, shpallen kampion në nivel vendi, ne garat shkollore.

Filloi ndërtimi i aneksit të gjimnazit në Malishevë

Malishevë, 15 qershor



Në vigjilje të shënimit të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, sot në Malishevë, filloi ndërtimi i aneksit të gjimnazit “Hamdi Berisha”. Në ceremoninë e fillimit të punimeve mori pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga stafi i tij.

“Uroj që shkollat tona të mbushen me nxënës dhe të kemi nevojë të vazhdueshme që të ndërtojmë objekte shkollore të reja, apo ti rrisim objektet aktuale. Investimet në infrastrukturën shkollore do të jenë gjithmonë prioritet për neve si institucione dhe jemi duke punuar fuqishëm në këtë drejtim”, tha kryetari Begaj, me rastin e fillimit të punimeve dhe vënies së gurëthemelit të aneksit të gjimnazit.



Numri shumë i madh i nxënësve dhe nevojat tjera për rritje të cilësisë në arsim, kanë bërë që të paraqitet nevoja për rritjen e hapësirës në gjimnazin e përgjithshëm në Malishevë.

U përkujtua dëshmori i parë i Malishevës, Imer Krasniqi

Malishevë, 15 qershor


Nesër më 16 qershor, 19 vite më parë, heroikisht ka rënë dëshmori Imer Krasniqi, i cili edhe ishte dëshmori i parë nga Komuna e Malishevës, i rënë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë qëllim, sot në vendlindjen e dëshmorit, është shënuar dita e shkollës, e cila mban emrin e dëshmorit dhe janë bërë nderime te busti i tij.

Nderime te busti i dëshmorit Imer Krasniqi, në oborrin e shkollës, kanë bërë, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, zyrtar tjerë komunal, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjarë dhe qytetarë të shumtë.

Imer Krasniqi, është dëshmori i parë nga Komuna e Malishevës, i rënë më 16 qershor 1998, ndërsa Mentor Gashi ishte dëshmori i fundit i rënë në ditën e çlirimit të Malishevës, më 16 qershor 1999 dhe për këtë shkak, Komuna e Malishevës, krahas shënimit të ditës së çlirimit më 16 qershor, shënon edhe ditën e dëshmorëve.

Shkolla e Dragobilit, bëhet me bibliotekë

Malishevë, 15 qershor



Falë iniciativës së shkrimtarëve lokal të Malishevës, nga sot, shkolla “Emin Duraku” në Dragobil, do të ketë në shërbim të nxënësve edhe bibliotekën e pasuruar me shumë libra, të cilat janë dhuruar nga shkrimtarët, shtëpitë botuese dhe institucione tjera. Në ceremoninë e hapjes së bibliotekës, morën pjesë, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, drejtorë të drejtorive, shkrimtarët nga Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë “Agim Deva” dhe dashamir të leximit.



Me rastin e hapjes së bibliotekës, është mbajtur edhe një orë letrare, ku fillimisht nxënësit e kësaj shkolle, kanë recituar poezi për librin, e më pas edhe shkrimtarët e njohur nga Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë, kanë lexuar poezitë e tyre, me temë librin dhe shkollën.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka përgëzuar shkollën dhe nxënësit, për këtë bibliotekë, ndërsa i ka falënderua të gjithë shkrimtarët prezent dhe të gjithë ata që kanë dhuruar vepra për pasurimin e kësaj biblioteke.

Të gjithë ata që kanë dhuruar libra, i ka falënderuar edhe shkrimtari Mehdi Krasniqi, i cili ka folur edhe si iniciator i kësaj iniciative, ku deri më tani janë hapur shtatë biblioteka në shkollat e Komunës së Malishevës. Për këtë kontribut të Krasniqit, edhe shkolla në Dragobil, e ka nderuar më një mirënjohje.

U mbajtën shumë aktivitete kulturore në vigjilje të shënimit të 16 Qershorit

Malishevë, 15 qershor



Në vigjilje të shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, janë mbajtur dhe po mbahen shumë aktivitete kulturore dhe sportive, e që të gjitha lidhen me festën e 16 Qershorit. Janë mbajtur orë letrare, ekspozita, shfaqje, si dhe janë prezantuar fituesit e konkurseve në krijimtari letrare, pikturë dhe muzikë.

Këto aktivitete, kanë qenë të planifikuara dhe janë mbajtur, duke filluar me një program për fëmijë, për të vazhduar me hapjen e ekspozitës artistike dhe publikimin e rezultateve të konkursit në lëmin e pikturës, pastaj një ore e madhe letrare dhe publikim i rezultateve të konkursit në fushën e krijimeve letrare, ndërsa aktivitetet e ditës së sotme, përfundojnë me finalen në turnir të futbollit të vogël dhe sportet tjera.



Në shumicën e këtyre aktivitete ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili edhe i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në këto aktivitete.

Malisheva po shënon 16 Qershorin, Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve

Malishevë, 16 qershor

Komuna e Malishevës, gjatë tërë ditës së sotme, përmes aktiviteteve të ndryshme është duke e shënuar 16 Qershorin, Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve. Aktivitetet kryesore që janë mbajtur gjatë ditës së sotme, janë mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Malishevës dhe manifestimi qendror, ku edhe janë ndarë çmimet tradicionale, që ndahen në këtë ditë të shënuar.

Aktivitetet e ditës së sotme kanë filluar me pritjen e mysafirëve në zyrën e Kryetarit të Komunës, Ragip Begaj, dhe kanë vazhduar me mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës. Në këtë mbledhje, fjalë rasti kanë mbajtur i pari i Malishevës, Ragip Begaj dhe kryesuesi i KK, Aziz Thaçi, të cilët kanë folur për rëndësinë e kësaj date, si dhe për përpjekjet e Malishevës, deri në çlirimin e saj.



Më pas janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjenda Adem Jashari, në sheshin e dëshmorëve në Malishevë si dhe janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.

Në ora 13:00, është mbajtur manifestimi qendror në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ku kryetari i komunës, ka mbajtur edhe fjalimin e tij tradicional. Në këtë fjalim Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, përveç që ka folur për përpjekjet e Malishevës gjatë historisë së saj, deri në luftën e fundit dhe çlirimin e saj, ka bërë edhe dy kërkesa publike, drejtuar institucioneve përgjegjëse. Kërkesa e parë ka qenë, ndriçimi i masakrave në Komunën e Malishevës, të kryera gjatë viteve 1998 dhe 1999 dhe kërkesa e dytë, ishte për kthimin e Komunës së Malishevës, në regjionin e Prizrenit, pasi padrejtësisht, pa u pyetur qytetarët e Komunës së Malishevës, janë dërgua me regjionin e Gjakovës.

Në këtë tubim, janë ndarë edhe çmimet tradicionale që KK i Malishevës i ndanë më 16 Qershor. Çmimi për trimëri dhe heroizëm “Imer Krasniqi”, këtë vit ju dha veteranëve të luftës, Nuhi Morina dhe Bukurie Zogaj, çmimi për kontribut në shkollën shqipe “Hamdi Berisha”, ju dha veteranëve të arsimit Ahmet Kasniqi dhe Ahmet Hoxha, ndërsa çmimi për kontribut në shëndetësi “Shpëtim Robaj”, ju dha mjekëve Besim Zogaj dhe Ali Krasniqi.



E veçanta e tubimit qendror ishte edhe shfaqja e dokumentarit për masakrat e Burimit dhe Gollubovcit, ku janë treguar mënyra e vrasjes dhe masakrimin të civilëve shqiptarë, të fshatrave Astrazup, Dragobil, Gollubovc, Plloçicë dhe të tjera. Ku janë pezmatuar dëshmi dhe faktografi për masakrat.

Aktivitetet e ditës së sotme, vazhdojnë me një koncert të madh në pakun e qytetit dhe përfundojnë me ndezjen e fishekzjarrëve.

Këshilli i Drejtorëve diskutoi për Kornizën Afatmesme Buxhetore

Malishevë, 19 qershor

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të së hënës, ku janë diskutuar shumë çështje, por më me rëndësi ka qenë procesi i hartimit të buxhetit për vitin 2018, si dhe realizimi i projekteve për këtë vit.

Sipas Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, qarkorja e parë buxhetore në kuadër të hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), është në përfundim e sipër dhe brenda këtij muaji, pritet miratimi në Kuvendin e Komunës. Bazuar në këtë qarkore dhe propozimet e bëra, buxheti i Komunës së Malishevës për vitin 2018, pritet të jetë 13 691 736 euro.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, u diskutua edhe për realizimin e projekteve kapitale, ku kryetari Begaj, ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse angazhim të shtuar për realizimin me kohë të të gjitha projekteve të planifikuara për këtë vit.

Sipas Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, sot ka filluar regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme të Komunës së Malishevës

Nga ana tjetër, drejtorët e drejtorive komunale, kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për këtë javë.

Filloi asfaltimi i 700 metrave rrugë në lagjet e Gurbardhit



Malishevë, 20 qershor



Sot në fshatin Gurbardh, ka filluar asfaltimi i rrugëve brenda lagjeve të fshatit. Asfaltimi i rrugëve bëhet në kuadër të investimeve në infrastrukturën rrugore në fshatrat e Komunës së Malishevës. Asfaltimin e këtyre rrugëve e ka parë nga afër edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, bashkë me drejtorin e urbanizmit Ahmet Morina dhe atë të administratës, Hajrullah Mazreku.

“Ne si qeveri komunale, po punojmë në rregullimin e infrastrukturës në përgjithësi, dhe në Komunën e Malishevës të gjitha rrugët kryesore janë të ndërtaura dhe asfaltuara. E mira e gjithë kësaj është se ne tani, po rregullojmë infrastrukturën brenda lagjeve në fshatrat e Malishevës. Qëllim i yni është krijimi i kushteve sa më të mira për qytetarët e Komunës së Malishevës, e në këtë rast edhe lëvizjen sa më të lehtë për qytetarët, pasi kjo sot është nevojë e kohës. Unë ju përgëzoj juve për këtë rrugë dhe ju garantoj se këto investime nuk do të ndalen, derisa infrastruktura të rregullohet, jo vetëm në qytet, por edhe në të gjitha vendbanimet”, tha Begaj, gjatë vizitës së tij në Gurbardh.

Drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, ka bërë të ditur se aktualisht, në Gurbardh, janë duke u asfaltuar 700 metra rrugë, në brendi të lagjeve dhe këto mundësohen nga buxheti komunal i Malishevës.

Viti shkollor afër përfundimit

Malishevë, 20 qershor

Në takim, me drejtorët e Shkollave të Mesme të Larta (ShML) dhe Shkollat Fillore dhe Mesme të Ulëta (ShFMU), Drejtoria e Arsimit dhe Edukimit në Malishevë, shqyrtoi përfundimin e gjysmë vjetorit të dytë, ku drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, kërkoi nga drejtorët e shkollave përmbushjen e obligimeve, deri në fundvitin shkollor 2016/2017.



Ai vlerësoi si mjaft sfidues, mësimdhënien dhe mësimnxënien në këtë vit shkollor, po ashtu edhe udhëheqjen dhe menaxhimin e ekipeve udhëheqëse të shkollave, pasi ishin në pilotim disa nga shkollat me mësimdhënie dhe mësimnxënie të Kurrikulës së re.

Për standardet dhe infrastrukturën shkollore, drejtori Morina theksoi se “qeveria Begaj ka përmbushur në plotësi kushtet për standardet dhe infrastrukturën, pasi tanimë pesëmbëdhjetë shkolla punojnë me një ndërrim dhe tri objekte të reja shkollore janë nisur këtë vit. Shkollat janë të pajisura me inventarë të duhur, janë hapur edhe shtatë biblioteka shkollore, palestra sportive, kabinete shkollore dhe pajisja me mjete të konkretizimit, gjë që bashkë me trajnimet e mësimdhënësve, priten suksese të më të mira për vitin shkollor 2017/2018, ku edhe do të jemi pjesë e vlerësimit PISA”.

Në këtë takim, i pranishëm ishte edhe zyrtari i MASHTI-t, Fehmi Krasniqi, ku informoi, drejtorët e shkollave, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 13/2016, se për klasat gjashtë deri në nëntë, vetëm dhjetë përqind (10%) e teksteve do të zëvendësohen, nga MASHT-i. Drejtori, Morina, krejt në fund, kërkoi nga drejtorët përgatitjet dhe planifikimet për vitin shkollor 2017/2018.

Begaj: Me hapjen e bizneseve të reja, po krijohen vende pune

Malishevë, 21 qershor

“Hapja e bizneseve të reja, apo zhvillimi dhe zgjerimi i bizneseve aktuale, po gjeneron vende të reja pune dhe ne i gëzohemi këtij zhvillimi në Malishevë”, ka thënë sot Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me rastin e ceremonisë së hapjes të qendrës tregtare “Lindi Center” në Malishevë. Me këtë rast, kryetari Begaj, e ka uruar pronarin dhe të punësuarit në këtë qendër tregtare.

“Tregtia si fushë e fuqishme e zhvillimit ekonomik, në Komunën e Malishevës, është mjaftë e zhvilluar dhe çdo ditë e më shumë, po gjeneron vende të reja pune. Edhe në këtë qendër tregtare, e cila sot po fillon punën e saj, po ashtu janë punësuar një numër i madh i punëtorëve që ndikon në uljen e numrit të të papunëve. Ne sigurisht i gëzohemi kësaj dhe për këtë qëllim, tani e disa vite me radhë i kemi ulur apo edhe i kemi hequr taksat, në mënyrë që bizneset të mund të zhvillohen. Hapja e kësaj qendre tregtare, është treguesi më i mirë i zhvillimit, por edhe i suksesit në këtë fushë”, tha mes tjerash kryetari Begaj.



Përndryshe, në këtë qendër tregtare, e cila ka filluar punën sot, sipas pronarit Ramadan Spahiaj, fillimisht i kanë angazhuar mbi 40 punëtor, ndërsa në të ardhmen synohet rritja e numrit të të punësuarve.

Ushtrimi fushor “Mirusha 2017”, në fazën finale të përgatitjeve

Malishevë, 21 qershor

Sot është mbajtur takimi i rregullt i grupit punues për përgatitjen e ushtrimit fushor “Mirusha 2017”, që duhet të mbahet më 11 dhe 12 korrik të këtij viti. Përgatitjet për mbajtjen e këtij ushtrimi kanë hyrë në fazën finale. Ky ushtrim fushor organizohet nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në bashkëpunim me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME), ndërsa qëllimi i këtij ushtrimi është, verifikimi i kapaciteteve në rastet emergjente.

Në takimin e sotëm, u tha se përgatitjet kanë hyrë në fazën finale dhe se janë duke koordinuar aktivitetet që do të zhvillohen me rastin e mbajtjes së këtij ushtrimi fushor, në të cilin do të marrin pjesë, të gjithë faktorët për menaxhimin e emergjencave eventuale, ku përfshihen organet përgjegjëse komunale, ekipet e zjarrfikësve dhe shpëtimit, Policia e Kosovës, shërbimet shëndetësore, organizatat i Kryqi i Kuq dhe faktorët tjerë, të cilët kanë obligime në rastet emergjente.

Në takimin e sotëm, është prezantuar skenari i përgatitur nga drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim dhe AME, ku përfshihet planifikimi, komunikimi dhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me rastet emergjente, si dhe obligimet e sektorëve tjerë, të përcaktuara sipas ligjeve dhe rregulloreve, për rastet emergjente.

Ushtrimi fushor “Mirusha 2017”, është i pari i këtij lloji që do të mbahet në Malishevë, ndërsa do të inskenohen tri raste të emergjencave, si vërshime, zjarre dhe aksidente në komunikacion, që vijnë si pasojë e kushteve atmosferike. Ky ushtrim do të mbikëqyret nga organet përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare.

Filloi hapja e dy rrugëve në Balincë



Malishevë, 22 qershor



Në kuadër të investimeve të Komunës së Malishevës, në infrastrukturën rrugore, nëpër lagjet e fshatrave, edhe në fshatin Balincë, ka filluar hapja dhe zgjerimi i dy rrugëve, të cilat i lidhin tri lagje mes vete dhe të cilat kanë rëndësi të shumëfishtë për këto lagje dhe këtë fshat. Punimet në këto rrugë sot i ka inspektuar, drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina.

“Punimet po ecin mirë dhe hapja, zgjerimi dhe rregullimi i këtyre rrugëve, është duke u bërë sipas planifikimit”, tha drejtori Morina gjatë inspektimit të punimeve. Drejtori Morina është takuar edhe me banorët e këtyre lagjeve, të cilët janë shprehur të kënaqur me këtë investim, që ka rëndësi të shumëfishtë.

Sipas banorëve, këto rrugë i lidhin tri lagje mes vete, pastaj ajo që është shumë me rëndësi për ta, lidhja e këtyre rrugëve, ju mundëson nxënësve që ta shkurtojnë rrugën për në shkollë, si dhe nxënësit tani nuk kanë nevojë të shkojnë në shkollë nëpër magjistrale.

“Qëllim i yni është krijimi i kushteve sa më të mira për të gjithë, përfshi edhe lëvizjen e lehtë dhe të sigurt për të gjithë banorët, e në rastin konkret për fëmijët të cilët deri më tani kanë shkuar në shkollë, përgjatë magjistrals”, tha Morina. Ai gjithashtu konfirmoi se këto dy rrugë, kanë një gjatësi prej një kilometri, ku përfshihet hapja e rrugëve, zgjerimi, krijimi i bazës dhe në fund asfaltimi dhe të gjitha këto bëhen nga buxheti komunal i Malishevës.

Edhe në Mleqan rregullohen rrugët brenda fshatit

Malishevë, 24 qershor

Sikur në të gjitha vendbanimet tjera, edhe në fshatin Mleqan të Komunës së Malishevës, ka filluar rregullimi i rrugëve brenda fshatit. Rrugët apo rrugicat në Mleqan, të cilat kanë filluar të hapen dhe do të asfaltohen, kanë një gjatësi prej 1 600 metrave. Punimet në rrugët e Mleqanit, i kanë parë nga afër edhe kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi dhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Aziz Thaçi, është ndarë i kënaqur me punët që po kryhen në këtë fshat, ndërsa i ka uruar banorët për hapjen dhe rregullimi i e këtyre rrugëve, brenda lagjeve, përmes së cilave lehtësohet qarkullimi i veturave dhe lëvizja e qytetarëve.

Ndërsa Ahmet Morina, drejtor i urbanizmit në Malishevë, tha se “punimet janë shkuar sipas planifikimeve dhe shumë shpejt këto rrugë do të rregullohen”. Morina gjithashtu tha se “bëhet fjalë për 1 600 metra në lagjet e Mleqanit, të cilat financohen nga buxheti i Komunës së Malishevës”.

KKSB: Malisheva komunë e qetë

Malishevë, 29 qershor

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka mbajtur sot takimin e tretë të radhës për vitin 2017, ku është diskutuar për sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevës. Situata e sigurisë në territorin e Komunës së Malishevës, u vlerësua e qetë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë.

Komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, tha se “duke u bazuar në raportet policore, situata e sigurisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Malishevës, është e qetë dhe stabile, e gjithashtu nuk ka tendencë, apo indikacione për prishjen e kësaj situatë”. Morina, gjithashtu deklaroi se, “me gjithë aktivitetet, sidomos në muajin qershor, ku përfshihen zgjedhjet e përgjithshme, muaji i Ramazanit, festimi i Bajramit dhe kremtimi i Ditës së Çlirimit të Malishevës dhe të tjera, nuk janë shënuar incidente”.

Halit Mazreku, zyrtar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, po ashtu tha se “edhe situata me EHKK, është e mirë dhe nuk ka raste të infektimit me EHKK, përderisa po vazhdohet me aktivitetet parandaluese, si dezinfektimi i zonave endemike, pastaj repelimi i kafshëve dhe aktivitetet tjera”.

Edhe anëtarët tjerë të KKSB-së, e ka vlerësuar të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, të cilët edhe i kanë përgëzuar të gjithë ata që janë të angazhuar në krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës.



KK i Malishevës, miratoi KAB-in dhe emërtoi stadiumin e qytetit

Malishevë, 30 qershor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e gjashtë të rregullt dhe mori disa vendime me rëndësi, si miratimi i draft Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe emërtoi stadiumin e qytetit me emrin e dëshmorit të kombit Liman Gegaj.

Fillimisht, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të Komunës, Ragip Begaj, për emërtimin e stadiumit të qytetit me emrin e dëshmorit Liman Gegaj, emër i cili gjithashtu e kishte përkrahjen e plotë të të gjitha shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, morën vendim për këtë emërtim dhe nga tani stadiumi i qytetit do të ketë emrin e dëshmorit Liman Gegaj.

Më pas, KK i Malishevës, mori vendim edhe për përkrahjen financiare, të stacionit të autobusëve në Malishevë, në formë të huadhënies.

Pas kësaj, para anëtarëve të KK të Malishevës, nga ana e drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, është paraqitur draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB), e cila është miratuar nga ana e anëtarëve të KK. Sipas KAB 2018-2020, Komuna e Malishevës, në vitin 2018, parashihet të ketë një ngritje të buxhetit.

KK ka miratuar edhe Planin e Veprimit Lokal Rinor 2017-2019, plan i cili para anëtarëve të kuvendit, është paraqitur nga drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi.

Kuvendi i Komunës, po ashtu ka miratuar edhe një kërkesë të një qytetari për ndërrim destinim të tokës, nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka shqyrtuar edhe kërkesën e kryesisë së fshatit Dragobil, lidhur me pronën e dhënë për një kompani, për ndërtimin e një fabrike për riciklim të mbeturinave, dhe e cila është kundërshtuar nga banorët. Sipas njoftimit të dhënë në KK, kompania aktualisht i ka ndërprerë punimet, ndërsa anëtarët e KK, kërkuan që në asnjë mënyrë të mos lejohet devijimi nga kontrata dhe të mos lejohen ndërtime pa leje dhe jashtë kontratës me komunën.

